

Dt. 18.01.2018

STATUTI
I
SHOQERISE "GALENIUM" SHPK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITESHME

Neni 1

Ortaku i vetem themelues i shoqerise "GALENIUM" shpk eshte **Z. Albert Shehu**, i biri i Sabit, lindur ne Maqellare, Diber, me date 29.02.1980, banues ne adrsen: Rruga "Lord Bajron", Blloku Gintash, Pallati Nr.37, Laprake, Tirane, me leternjoftim Nr.027853322,

Neni 2

Aktiviteti tregtar i shoqerise "GALENIUM" shpk, ne vazhdimesi do te organizohet dhe funksionojne ne baze te dispozitave te ketij statuti, ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe ne baze te legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Neni 3

KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT

Aktivitetit te shoqerise do te ushtrohet per nje periudhe kohe te pakufizuar.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- Ofrimin e sherbimeve rregullatore dhe rregjistrimin e medikamenteve;
- Ofrimin e sherbimeve te marketingut mjekesore dhe medrep;
- Kryerjen e perkthimeve te specializuara te akteve te ndryshme ne fushen e mjekesise dhe farmaceutikes.

Neni 5

Për përmbushjen e objektit te veprimtarisë, shoqëria mund te marre pjese ne ndërmarrje apo shoqëri te tjera qe kane objekt te njëjte ose te përafërt me te sajin dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter te luajtshëm e te paluajtshëm.

Shoqëria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhëse ne leke apo valuta te tjera, pranë bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluar ne to, në përputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 6

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë eshte ne adresën: Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati "Hekla", seksioni B, Kati 2, Tirane.

Asambleja ka kompetencën te hape filiale dhe dege te tjera dhe t'i mbylle ato, nëse e quan te nevojshme.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA
Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 10.000, (dhjetemije) Leke.

Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote e vetme me vlere 10.000, (dhjetemije) Leke, i cili zoterohet tereresisht nga ortaku i vetem i shoqerise **Z. Albert Shehu**.

Për vërtetimin e pronësisë mbi kuotat e mësipërme shoqëria tregtare mund të lëshojë në emër të personit, që zotëron kuotën, një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

Ortaku i vetem me kerkese te Administratorit dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi te karakterit fiskal, kane te drejte te kryejne pagesa apo te japin kontribute, ne kapital, ose financime ne favor te shoqerise, te cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financiar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit te tyre rregullohen me kontraten perkatese. Shumat e mesiperme mund te perdoren per te mbuluar humbjet ose trasferohen direkt ne rritjen e kapitalit ne perputhje me vendimin e asamblese se ortakeve.

KREU III
TRANSFERIMI (KALIMI) I KUOTES SE KAPITALIT THEMELTAR
Neni 8

Kuota e kapitalit themeltar eshte lirisht e transferueshme tek te tretet. Transferimi (kalimi) i kuotes mund te behet me kontrate shitblerje, me kontrate dhurimi, me trashegimi, dhe ne çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

KREU IV
ASAMBLEJA
Neni 9

Asambleja e Përgjithshme është organi me i larte vendimor i shoqërisë qe përfaqëson mbledhjen e pergjitheshme te ortakeve te shoqerise.

Ne shoqerine "GALENIUM" shpk, atributet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem Z. Albert Shehu.

Vendimet e asamblese se pergjithshme merren ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe Statutin e kesaj shoqerie dhe jane te detyrueshme për te gjitha organet e shoqerise. Vendimet asamblese protokollohen ne regjistër te veçante ne përputhje me ligjin.

Asambleja ka te drejte te ushtroje ne çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe te kontrolloje çdo dokument te shoqërisë. Ajo mund te urdhëroje apo te udhëzoje administratorin/et ne kryerjen e detyrës se tij.

Asambleja ka keto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive te zhvillimit, perfshire edhe investimet kapitale;
- Vendos per ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe audituesit ligjore, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/et, miraton buxhetin vjetor dhe raportet e ecurisë se veprimtarisë;

- Vendos per zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos per pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos per riorganizimin (shendrrimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise);
- Vendos prishjen e shoqërisë dhe kalimin e saj ne likuidim;
- Vendos per transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkembimin) e pasurive te shoqerise, per cedimin apo per dhenien me qira te shoqerise ose degeve te saj, per dhenien me qera te aseteteve te shoqerise, per marrjen me qera te objekteve apo aseteteve te ndryshme, per kontratat leasing, per pjesemarrjen ne kapitalin e kompanive te tjera nepermjet pjesemarrjes ne kapital, blerjes se kuotave apo aksioneve;
- Vendos per miratimin e huamarrjeve me interes nga te tretet, si dhe per huamarrjet pa interes;
- Vendos per dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguruese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e audituesve ligjore;
- Miraton shperdarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve, vendos per ndarjen e dividenteve ose per kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit te kapitalit;
- Miraton strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme dhe organigramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikat dhe nivelin e pagave dhe shperblimeve per cdo vend pune ne shoqeri;
- Vendos për çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji;

Neni 10

MËNYRA E THIRRJES, PERFAQESIMI DHE VENDIMARRJA E ASAMBLESE.

Asambleja e përgjithshme thirret në menyren e percaktuar ne nenin 83 e vijues te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

Perfaqesimi i ortakut/eve ne asamble behet sipas rregullave te percaktuara ne 83 e vijues te Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 % të kapitalit te shoqerise (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me **75%** (shtatedhjetepesepersqind) te votave te ortakeve pjesemarrres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrrimi, bashkimi, ndarja) ;
- Prishja e shoqerise dhe kalimi i saj ne likuidim;
- Shperndarja e fitimeve, kapitalizimi i tyre ose mbulimi i humbjeve;

- Percaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shpërblimeve për çdo pozicion pune në shoqëri, duke përfshirë edhe përcaktimin e pages apo shpërblimit të Administratorit, audituesve ligjorë dhe likuiduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, refuzon kërkesën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar, për nisjen e një hetimi të posaçëm ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve atëherë, kërkuarit kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës.

Neni 11 **ZMADHIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Zmadhimi i kapitalit themeltar vendoset nga Asambleja me **75%** (shtatedhjetë e pesë) % të votave të ortakëve pjesëmarrës. Pas vendimit të asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortaku brenda 30 ditëve duhet të bëjë derdhjet respektive, në proporcion me kuotën e kapitalit që zotëron secili.

Ortaku që kanë votuar kundër zmadhimit të kapitalit nuk janë të detyruar të kontribuojnë.

Depozitimi i kapitalit të zmadhuar, bëhet vetëm nga ortaku/et që kanë votuar pro rritjes së kapitalit, secili sipas kuotës që është vendosur në asamble. Në mungesë të marrëveshjes për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes së kontributeve të sipërpërmendura, Administratori/et duhet të regjistrojnë në librin e ortakut zmadhimin e kapitalit, duke marrë nënshkrimin dhe nëshkrimin e tij.

Administratori/et në bazë të ligjit dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'u kërkojnë informacione ortakut kur ai ka nënshkruar zmadhimin e kapitalit, në lidhje me derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12 **ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja me **75%** (shtatedhjetë e pesë për qind) të votave të ortakëve pjesëmarrës.

Kur vendimi i zvogëlimit të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë. Kreditorët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 **SHNDERRIMI**

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri aksionare, bëhet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave, në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozitë.

Neni 14 **ADMINISTRIMI**

Administrimi i shoqërisë i besohen Administratorit te vetëm, **Z. Erind Merkuri**, i biri Jordanit, lindur ne Durres me dt 12.10.1984, banues ne adresen: Rruga "Xhavid Shyqyri Demneri", Pallati Nr.35, hyrja Nr.4, Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr.28000289.

Administratori emërohet për një periudhe prej 5 vjetesh me te drejte ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Administratori gëzon kompetenca te pakufizuara për realizimin e objektit te veprimtarisë se shoqërisë, me përjashtim te atyre kompetencave qe Statuti ia njeh Asamblesë se Pergjithshme.

Ne përmbushje te detyrës se tij, ai ka te drejten dhe detyrimin qe te kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe konkretisht :

- Te zbatoje politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Te përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- Te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Te përgatis dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- Te krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Te kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund te vere ne lëvizje organe administrative dhe gjyqësore, duke autorizuar avokate dhe lëshuar autorizime ne raste mosmarreveshjes gjyqësore, duke kryer operacione bankare, këtu përfshire edhe hapjen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti. Administratori ka të drejtë që të autorizojë edhe persona të tjerë për të ushtruar, pjesërisht apo plotësisht, kompetencat e tij administrative dhe vendimmarrëse në shoqëri dhe që kanë të bëjnë me të gjitha marrëdhëniet juridike që mund të krijohen, marrëdhëniet me institucionet publike apo me të tretë, etj. Administratori mund të dorëhiqet në çdo kohë.

Viti financiar fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

Neni 15

Administratori mund te emëroje përfaqësues, te cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë te drejtën e firmës, duke i përcaktuar kompetenca, shpërblime dhe garanci qe do te vlerësoje te arsyeshme. Ai mundet gjithashtu te emëroje drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh te caktuar.

Neni 16

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori (apo administratorete nese do te emërohen te tille) janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose te tretëve, për shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj te tretëve, për aktivitete dhe transaksione të kryera nga administratori në kapercim të kompetencave të tij, kur vërtetohet se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose te tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke e shoqëruar me motivacionin përkatës. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorëve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administratori/ret mund të heq/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori/ret, që paraqet dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja e tij të kete hyre në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

PERFAQESIMI I PUNEMARRRESVE

Neni 18

Nëse shoqëria ka me shume se 50 punemarrës atëherë ata kanë të drejtën të organizojnë një Këshill të punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me të drejtë ripërtëritje ose kur shoqëria ka të punësuar me shume se 20 punëmarrës po me pak se 50, atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

AUDITUESIT LIGJORE

Neni 19

Emërimi i audituesve ligjore behet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e audituesit ligjore, janë të pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Neni 20

Audituesi ligjore pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton që kontabiliteti vjetor është mbajtur në rregull, i korrespondon të vërtetës dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Audituesi ligjore mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim të asamblesë së përgjithshme si dhe me vendim gjykatë.

Audituesi ligjore përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor që pasqyron situatën financiare në nisje dhe atë në mbyllje.

Ai kontrollon që bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblesë, t'i korrespondojë realitetit.

Audituesi ligjore është i detyruar ti paraqesë Administratorit dhe asamblesë se ortakeve:

- a) Kontrolllet, verifikimet dhe sondazhet e bëra ;
- b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël qe duhet korrigjuar duke sygjeruar edhe zgjidhjet;
- c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara;
- d) Rezultatin financiar pas korrigjimeve te bëra;

Ai duhet te thirret ne te gjitha mbledhjet e asamblesë se ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund te thirret ne te gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 21

Audituesi ligjore përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj te tretëve për pasojat e negative qe rrjedhin nga gabime e neglizhime ne kryerjen e funksionit te tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore te kryera nga administratori, me përjashtim te rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar para asamblesë.

KREU IV **FITIMI DHE FONDET RREZERVE**

Neni 22

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur.

Asambleja mund te vendose për formimin dhe shpërndarjen e fondeve te ndryshme.

Neni 23

Asambleja vetem pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakun e vetem.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut te vetem, vetëm nëse administratori apo administratoret, nen përgjegjësinë tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare".

Gjate vitit, shoqëria ka te drejte t'i japë ortakut te vetem paradhënie mbi dividendët ne vlera jo me te mëdha se dividendi i shpërndarë një vit me pare, me kusht qe:

a) Te mbetet e depozituar një rezerve, e barabarte me paradhëniet qe do te shpërndahen;

b) Një audituesi ligjore te vërtetoje ne një relacion me shkrim qe fitimet neto te realizuara deri ne atë moment janë me te mëdha se paradhëniet qe parashikohen për tu shpërndare ortakeve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga asambleja ose administratori. Ne vendimin përkatës duhet te specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

KREU V **PAVLEFSHMERIA E SHOQERISE, PRISHJA, LIKUJDIMI DHE LARGIMI I ORTAKEVE**

Neni 24

Pavlefshmeria e themelimit të shoqërisë, mund te konstatohen apo te shpallen vetem nese plotesohen nje apo disa nga kushtet e parashikuara ne nenin 3/1 te Ligjit "Per tregtaret

dhe Shoqërite Tregtare". Pasojat e pavlefshmerise, do te zgjidhen ne perputhje me kerkesat e dispozites se sipercituar.

Neni 25

Shoqëria mund te priset vetem ne keto raste:

- a) Për çdo shkak të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) Kur mbaron afati i veprimtarise se percaktuar ne Statut dhe asambleja nuk merr vendim per zgjatjen e afatit te veprimtarise;
- d) Në rast se bëhet i parealizueshëm objekti i veprimtarise se shoqërise, për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve drejtuese të shoqërisë (asamblese se pergjithshme) apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- dh) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara ligj;
- e) Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

Neni 26

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAVEKE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë pasi te njoftoje me shkrim për arsyet e largimit shoqërinë.

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Ne rastet e largimit, përjashtimi dhe zgjidhjes se pasojave per keto raste zbatohen parashikimet e neneve 102, 103 dhe 104 te Ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 27

LIKUIDIMI

Kur me vendim gjykate shpallet pavlefshmëria e shoqërisë, si dhe ne rastet e parashikuara ne statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme te shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit qe do te kryhen sipas kërkesave te parashikuara ne ligjin "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

ORTAKU I SHOQERISE "GALENIUM" SHPK

